



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 119, datë 15.03.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR
PERIUDHËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARES
{...}
2017-2019

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI I PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja në bazë të kategorisë së çështjes (gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale në fazën e hetimit paraprak), përshkruan në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit faktet e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, si gjatë gjykimit në

shkallë të parë,¹ ashtu edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit ka vendosur që të përsërisë pjesërisht shqyrtimin gjyqësor të çështjes.² Në një rast gjyqtarja nuk përshkruan faktet e çështjes, por përshkruan rrethanat procedurale, për shkak të natyrës së disponimit të gjykatës për mospranimin e ankimit, në kushtet kur ankimi ka mbetur pa objekt.³

Edhe pse në vendimet e analizuara nuk rezulton një nën pjesë e titulluar “*Rrethanat e faktit*”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe duke i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Në rastet kur shkaqet e ankimit nuk i referohen përcaktimit të gabuar të rrethanave të faktit, për përcaktimin e këtij të fundit, gjyqtarja nuk ripërsërit dhe as liston provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Ajo i përmbahet dhe evidenton faktet e provuara në gjykimin në shkallë të parë në një ndarje të veçantë të vendimit në fillim të pjesës arsyetuese.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), në mënyrë të pavarur nga çka kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre dhe këtë e bën si pjesë të një procesi vlerësimi të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Citimi dhe analiza e fakteve bëhet edhe tek pjesa e vlerësimit ligjor mbi çështjen, ku analizohen provat mbi të cilat mbështeten dhe provohen faktet e çështjes, si në rastet kur vlerësimi i tyre nga gjykata e shkallës së parë është gjetur i drejtë, ashtu edhe në rastet kur gjykata e apelit ka vlerësuar ndryshe elementë të caktuar të faktit. Në çdo dokument ligjor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon, për cilësim të saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes – Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja konkludon në vendim për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo penale, si dhe institutin përkatës juridik (*shpërblim dëmi, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kundërshtim veprimesh përmbare, zgjidhje kontrate, gjykim penal themeli, kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushim procedimi, kërkesë për njohje vendimi civil të huaj apo kërkesë për aplikimin e dënimit alternativ, caktim mase sigurimi....etj.*).

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës dhe përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467, paragrafi 1 germa “a” e K.Pr.Civile.⁴ Gjithashtu

¹Vendimi nr.79, datë 01.06.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²Vendimi nr.168, datë 30.04.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³Vendimi nr. 354, datë 19.12.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁴Në vendimin nr.421, datë 18.06.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjykata ka konstatuar se mosmarrëveshja lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme hyn në juridiksionin e gjykatave administrative pasi detyrimi i një organi administrativ të regjistrojë pronën, pra të kryej një veprim administrativ të caktuar përbën një konflikt të natyrës administrative. Analiza e natyrës së mosmarrëveshjes objekt gjykimi, në këtë rast i shërben gjykatës për të konkluduar lidhur me detyrën e

evidentohet se përcaktimi i saktë i natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve përbën një element përcaktues, për të orientuar arsyetimin ligjor të vendimit, si dhe në disa raste natyrën e gjykimit.⁵ Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që përcaktimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi, kuptohet qartësisht referuar analizës së secilit element të kërkuar nga ligji.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale, të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e pretendimeve për shkelje procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, pune apo shpërblim dëmi, pavlefshmëri titulli apo kundërshtim veprimesh përmbare), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse, konkretisht:

- Në vendimin me objekt fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, gjyqtarja identifikon ligjin nr.8743, datë 2.01.2001 “Për pronat e paluajtshme shtet”, ndryshuar me ligjin nr.9558, datë 08.06.2006 si dhe ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;⁶
- Në vendimin me objekt pavlefshmëri titulli, kontratë kredie bankare, gjyqtarja identifikon dhe citon nenet 79, 81 dhe 92 pika “a” të K.Civil, lidhur me veprimin juridik, detyrimin e nënshkrimit të veprimit juridik nga personi që e kryen atë, si dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik. Gjithashtu, në këtë vendim identifikon dhe citon dispozitën ligjore nenin 609 të K.Pr.Civile, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv;⁷
- Në vendimet me objekt pavlefshmërinë e faturave të energjisë elektrike, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitën relevante, nenin 609 të K.Pr.Civile, ndryshuar me ligjin nr.114/2016, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, dispozitat ligjore të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, vendimet e ERE-së nr.902, datë 15.11.2010 dhe nr.42, datë 22.04.2011. Identifikon ligjin nr.8369/1998, të ndryshuar me ligjin

gjykatës së shkallës së parë në rigjykim për të orientuar palën paditëse me qëllim saktësimin e objektit të kërimit të tij.

⁵Në vendimin nr.79, datë 01.06.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër, gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes duke specifikuar se në nenet 393-398 të K.Pr.Civile është sanksionuar kërkesa për njohjen e vendimit civil të huaj, e cila realizohet nëpërmjet gjykimit pa palë kundërshtare në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu, në vendimin nr.488, datë 17.07.2019 dhe në vendimin nr.197, datë 28.03.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes, duke evidentuar se bazuar në nenin 610 të K.Pr.Civile, padia me objekt “kundërshtim veprimesh përmbare” merret në shqyrtim në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, ku analizohet vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe shkaqet e ankimit.

⁶Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷Vendimi nr.78, datë 13.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

nr.8662/2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, lidhur me cilësinë e titullit ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike;⁸

- Në vendimin me objekt dëmshpërblim që rrjedh nga marrëdhënia e punës, gjyqtarja citon nenet 141, 143/1, 144/5 të K.Punës në lidhje me afatet e njoftimit dhe procedurën në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës;⁹
- Në vendimin me objekt shpërblim dëmi, gjyqtarja citon nenin 11 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe Rregulloren nr.53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”;¹⁰
- Në vendimet me objekt kundërshtim veprimesh përmbartimore, gjyqtarja identifikon dhe citon nenin 610 të K.Pr.Civile, lidhur me padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore, si dhe shqyrtimin në apel të kësaj padie.¹¹

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, në vendimet civile evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile si më poshtë:

- neni 199 i K.Pr.Civile lidhur me kalimin procedural për shkak se gjatë gjykimit paditësi ka ndërruar jetë;¹²
- nene 193 dhe 14 i K.Pr.Civile, lidhur me thirrjen në proces të personit të tretë dhe detyrimin e gjykatës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;¹³
- nenei 72 dhe 467 i K.Pr.Civile, lidhur me heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe dërgimin e çështjes për rigjykim për shkak të cenimit të parimit të paanësisë;¹⁴
- neni 394, 396 dhe 397 të K.Pr.Civile në lidhje me rrethanat që pengojnë njohjen dhe zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja, aktet e nevojshme që i bashkëlidhen kërkesës për njohje vendimi, si dhe lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit;¹⁵
- neni 106 të K.Pr.Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore;¹⁶

Në çdo vendim gjyqësor, evidentohet norma procedurale neni 459 dhe 465 i K.Pr.Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, duke treguar kujdesin e duhur që shqyrtimi i çështjes t’i referohet vetëm shkaqeve të pretenduara nga palët në ankim.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, por edhe në ligjet e posaçme në rastet kur dispozita penale është një dispozitë “*blanket*” e cila të referon tek ligji organik, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, konkretisht:

- nenet 78-22, 278/3, 84 të K.Penal në lidhje me ekzistencën e fakti penal. Citon nenin 6 të ligjit nr.141/2016 “Për dhënie amnistie”, lidhur me pushimin e çështjes

⁸Vendimet nr.336, datë 16.05.2019, nr.724, datë 07.11.2018 dhe nr.208, datë 26.03.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁹Vendimi nr.312, datë 11.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁰Vendimi nr.359, datë 25.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹¹Vendimi nr.488, datë 17.07.2019 dhe nr.197, datë 28.03.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹²Vendim nr.312, datë 11.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹³Vendimi nr.208, datë 26.03.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁴Vendimi nr.197, datë 28.03.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁵Vendimi nr.79, datë 01.06.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁶Vendimi nr.359, datë 25.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

penale në ngarkim të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal;¹⁷

- nenet 79/dh, 82 dhe 300 të K.Penal, lidhur me kualifikimin e faktit penal në ngarkim të të pandehurve;¹⁸
- nenet 76-22 dhe 82 të K.Penal, lidhur me kualifikimin e faktit penal në ngarkim të të pandehurit. Citon dhe identifikon nenet 48 paragrafi 1, shkronja b, 82 dhe 88/a të K.Penal, me qëllim për të analizuar dallimin midis ndikimit dhe tronditjes së psikike, si rrethanë lehtësuese që ndikon në uljen e dënimit dhe gjendjes së tronditjes psikike. Citon nenet 20 dhe 47 të K.Penal, lidhur me nevojën ekstreme dhe caktimin e dënimit;¹⁹
- nenin 291 të K.Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale. Po ashtu, gjyqtarja citon nenin 63 të K. Penal në lidhje me individualizimin e dënimit dhe aplikimit të alternativës së dënimit “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik”;²⁰
- nenin 89 të K.Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale, si dhe nenin 59 të K. Penal në lidhje me individualizimin e dënimit, lidhur me aplikimit të alternativës së dënimit “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim”;²¹
- nenet 283/2 dhe 284 të K.Penal në funksion të cilësimit juridik të veprave penale, për të cilat akuzohet i pandehurit, si dhe dispozitat materiale të ligjit të posaçëm nr.8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope”, që kanë lidhje me faktin penal;²²
- nenin 135 të K.Penal, me qëllim analizimin e veprimeve të kryera nga e kallëzuara, nëse përbënin elementët e figurës së veprës penale, parashikuar nga dispozita e mësipërme. Në këtë kontekst gjyqtarja citon dhe marrëveshjen dypalëshe nr. 4537/1932 prot., datë 21.08.2008 “Për pagesat e përfitimeve nga sigurimet shoqërore e shëndetësore” lidhur mes ISSH-së dhe Postës Shqiptare sh.a., si dhe akt marrëveshjen nr.3341, datë 25.06.2014 “Për transmetimin në formë elektronike të përfitimeve të njohura dhe pagesën e këtyre përfitimeve”;²³

Në çdo rast në të gjitha vendimet penale të analizuara referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, nenet 47, 48, 49, të K.Penal në lidhje me individualizimin e dënimit, apo nenet 59 dhe 63 K.Penal në lidhje me zbatimin e alternativave të dënimit.

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, në vendimet penale evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale penale si:

- nenet 149 dhe 152 të K.Pr.Penale, lidhur me konceptin juridik të provave dhe çmuarjen e tyre;²⁴
- nenet 93 dhe 403 të K.Pr.Penale, në lidhje me ndarjen e çështjes penale, me qëllim analizimin e pretendimit të të pandehurit për shkelje të rënda procedurale që kanë të bëjnë me veçimin e çështjes dhe mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar;²⁵

¹⁷Vendimi nr.728, datë 23.07.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁸Vendimi nr.175, datë 03.05.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁹Vendimi nr. 940, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁰Vendimi nr.65, datë 02.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²¹Vendimi nr.594, datë 11.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²²Vendimi nr.168, datë 30.04.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²³Vendimi nr.320, datë 27.11.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁴Vendimet nr. 728, datë 23.07.2018 dhe nr.540, datë 25.05.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

- Në vendimin me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, gjyqtarja identifikon nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit;²⁶
- nenet 412 dhe 420 të K.Pr.Penale, lidhur me ankimin dhe rastet e mospranimit të ankimit;²⁷
- nenet 328 dhe 329 të K.Pr.Penale, lidhur me kompetencat e prokurorit në marrjen e vendimit të mosfillimit të çështjes, pushimin e hetimeve apo dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe kontrollin gjyqësor të këtyre vendimeve, para dhe pas ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin 35/2017;²⁸
- Në të gjitha vendimet penale të analizuara evidentohet citimi i dispozitës procedurale penale , nenin 425/1 të K.Pr.Penale, i ndryshuar me ligjin nr.35, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të ankimit.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

²⁵Vendimi nr.175, datë 03.05.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁶Vendimi nr.87, datë 02.05.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁷Vendimi nr.354, datë 19.12.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁸Vendimi nr.320, datë 27.11.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës, sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*) dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit. Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik të tyre, apo në këndvështrimin historik (*ndryshimet e ligjeve*) dhe krahasues të tyre,²⁹ në funksion të përcaktimit të qëllimit të ligjit të zbatueshëm.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës. Interpretimi i normës lidhet gjithmonë me faktet e provuara.

(i) Në vendimet civile: Në të gjitha vendimet civile të analizuara interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja interpreton:

- nenin 451/a të K.Pr.Civile, lidhur me vendimin e gjykatës që përbën gjë të gjykuar dhe fuqinë juridike të tij,³⁰
- nenet 4 dhe 7 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në kuptim të rregullave për juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative. Në funksion të analizimit të ndërgjyqësisë, gjyqtarja interpreton nenin 6 të ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 “Për pronat e paluajtshme shtet”, si dhe nenin 8 të ligjit nr.7843, datë 123.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Në këtë kontekst, gjyqtarja interpreton në mënyrë të përgjithshme VKM nr.500, datë

²⁹Në vendimin nr. 728, datë 23.07.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër, gjyqtarja interpreton nenin 278 të K.Penal, i cili sanksionon mbajtjen pa leje të armëve luftarake, duke u ndalur në mënyrë të veçantë te ndryshimet që ka pësuar ky nen. Gjithashtu në vendimin nr.320, datë 27.11.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, gjyqtarja interpreton nenet 328 dhe 329 të K.Pr.Penale, lidhur me kompetencat e prokurorit gjatë hetimit dhe marrjes së një vendimi përkatës, si dhe kontrollin gjyqësor të këtyre vendimeve, para dhe pas ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin 35/2017.

³⁰Vendimi nr.446, datë 27.06.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

- 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, lidhur me procedurën e inventarizimit të të pronave të paluajtshme shtetërore;³¹
- neni 79 i K.Civil lidhur me konceptin e veprimit juridik, në funksion të analizimit të natyrës së kontratës së kredisë bankare, si një veprim juridik i dyanshëm, si dhe në funksion të analizimit të pasojave juridike në rastin e cenimit të kushteve të vlefshmërisë së veprimit juridik. Në vijim të analizës së mësipërme gjyqtarja interpreton në mënyrë sistematike nenet 81 dhe 92 pika “a” të K.Civil, lidhur me dispozitën urdhëruese të ligjit që sanksionon detyrimin për nënshkrimin e veprimit juridik, nga personi që e kryen atë dhe pasojën juridike në rastin e mosrespektimit të kësaj dispozite;³²
 - interpreton në mënyrë literale nenit 141 të Kodit të Punës, lidhur me afatin e zgjidhjes së kontratës;³³
 - interpreton në mënyrë literale dhe sistematike nenin 11 të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe nenin 2 të Rregullores nr.53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke analizuar kriteret ligjore që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për kërkimin e një dëmshpërblimi pasuror apo jopasuror; interpreton në mënyrë sistematike nenet 6 dhe 9 të Rregullores nr.53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, lidhur me afatin e trajtimit nga siguruesi përgjegjës të kërkesës për dëmshpërblim dhe pasoja juridike në rast të mosrespektimit të këtij afati;³⁴
 - në vendimet me objekt pavlefshmëri titulli (*fatura energjie elektrike*) gjyqtarja interpreton në mënyrë të përgjithshme dispozitat e ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimet e marra në zbatim të tij. Interpreton në mënyrë sistematike nenin 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me nenin 44 të po këtij ligji dhe vendimin nr.77, datë 15.10.2010 të ERE, duke argumentuar se ERE është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave për të gjitha veprimtaritë që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe se funksionimi i rrjetit kryhet në përputhje me dispozitat e kodit të Funksionimit të Shpërndarjes, që miratohet nga ERE. Në vijim të kësaj analize interpreton në mënyrë abstrakte ligjin nr.8369/1998, ndryshuar me ligjin nr.8662/2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, në funksion të argumentimit se faturat e energjisë elektrike përbëjnë titull ekzekutiv;
 - interpreton në mënyrë sistematike nenin 14 të vendimit 108/2011 me nenin 609 të K.Pr.Civile, lidhur me pretendimin e ngritur nga pala e paditur se padia është ngritur jashtë afatit ligjor, për të konkluduar se afati dhe procedura e ankimit kufizon në kohë të drejtën e abonentit familjar për tu ankuar dhe parashtruar kundërshtimet përballë palës tjetër kontraktore dhe nuk ka të bëjë me të drejtën e ngritjes së padisë për t’ju drejtuar gjykatës për pavlefshmëri titulli, bazuar në nenin 609 të K.Pr.Civile.³⁵

³¹Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³²Vendimi nr.78, datë 13.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³³Vendimi nr.312, datë 11.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³⁴Vendimi nr.359, datë 25.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

³⁵Vendimi nr.724, datë 07.11.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- *Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile;*

Gjykata referuar pretendimeve të ngritura nga ana e palëve në ankim, interpreton në përputhje me rrethanat e faktit:

- neni 454 i K.Pr.Civile në lidhje me elementët e detyrueshëm që duhet të përmbaj akti i ankimit ndaj një vendimi gjyqësor;³⁶
- nenet 12, 14 dhe 16 i K.Pr.Civile në lidhje me barrën e provës, detyrimin e gjykatës për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen apo parimet e përgjithshme të procesit gjyqësor civil;³⁷
- nenin 395, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, në funksion të evidentimit të kompetencës tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër;³⁸
- nenin 193 të K.Pr.Civile, lidhur me thirrjen në proces të personit të tretë;³⁹
- nenin 610 të K.Pr.Civile, lidhur me të drejtën e pjesëmarrësve në një procedurë ekzekutimi (*kreditor, debitor*) për të kundërshtuar çdo veprim të përmbaruesit gjyqësor, afatin e ankimit, si dhe karakteristikat individuale të të procesit përmbarimor.⁴⁰

Në të gjitha vendimet penale të analizuar gjyqtarja analizon të katër elementët e figurës së veprës penale në çështjet e themelit. Në këto të fundit, gjyqtarja përqendrohet më tepër në elementë të anës objektive të veprave penale, me qëllim cilësimin e saktë juridik të faktit penal. Konkretisht konstatohet se gjyqtarja interpreton:

- nenin 78/2 të K.Penal në lidhje kualifikimin juridik të faktit penal atribuar të pandehurit, duke analizuar çdo pretendim të tij të ngritur në ankim, si dhe duke analizuar çdo provë, e cila i është nënshtruar hetimit gjyqësor; nenin 278 të K.Penal i cili sanksionon mbajtjen pa leje të armëve luftarake, duke e ndaluar në mënyrë të veçantë të ndryshimet që ka pësuar ky nen;⁴¹
- nenet 79/dh dhe 82 të K.Penal, duke bërë dhe dallimin midis këtyre figurave të veprave penale, lidhur me gjendjen e ndikimit dhe tronditjes psikike, si rrethanë lehtësuese që ndikon në uljen e dënimit, sipas nenit 48, paragrafi 1, shkronja “b” të K.Penal dhe gjendjes së tronditjes psikike, të parashikuar nga neni 82 dhe 88/a të K.Penal;⁴²
- nenin 20 të K.Penal, lidhur me institutin e nevojës ekstreme në funksion të vlerësimit të pretendimit të të pandehurit për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale “*Vrasja në kushtet e tronditjes së fortë psikike*”, të parashikuar nga neni 82 të K.Penal në “*Nevojë ekstreme*”, parashikuar nga neni 20 i K.Penal;⁴³
- interpreton në mënyrë literale nenin 89 të K.Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilat akuzohet i pandehuri;⁴⁴
- nenet 283/1 dhe 2 të K.Penal në aspektin teorik të saj për efekt të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Në përputhje me rrethanat e faktit dhe provave të administruara të cilat për shkak të procedimit të çështjes me gjykim

³⁶Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁷Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁸Vendimi nr.79, datë 01.06.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁹Vendimi nr.208, datë 26.03.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁰Vendimi nr.488, datë 17.07.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴¹Vendimi nr.728, datë 23.07.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴²Vendimi nr.175, datë 03.05.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴³Vendimi nr.940, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁴Vendimi nr.594, datë 11.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

të zakonshëm në shkallë të parë, si dhe për shkak të përsëritjes pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit rezulton se është analizuar vlera provuese e çdo prove të administruar. Interpreton nenin 284 të K.Penal, lidhur me faktin penal në ngarkim të një prej të pandehurve. Në këtë kontekst me qëllim dallimin e kësaj vepre penale nga vepra e parashikuar nga neni 283 e K.Penal gjykata jep konceptin e “*kultivimit*” duke referuar në ligjin nr.8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope”;⁴⁵

- nenin 135 të K.Penal, me qëllim analizimin e veprimeve të kryera nga e kallëzuarja, nëse përbënin elementët e figurës së veprës penale, parashikuar nga dispozita e mësipërme;⁴⁶

Në të gjitha vendimet e mësipërme penale interpretimin e normave relevante gjyqtarja nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e veprave penale, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Referuar provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe të analizuar në tërësinë e tyre, gjyqtarja konkludon për cilësimin juridik të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të autorëve për veprën penale që atyre u atribuohet.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht gjyqtarja interpreton:

- nenin 93 të K.Pr.Penale, në lidhje me ndarjen e çështjes penale, me qëllim analizimin e pretendimit të të pandehurit për shkelje të rënda procedurale që kanë të bëjnë me veçimin e çështjes dhe mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar. Interpreton dhe zbaton mbi faktet e çështjes nenin 403 të K.Pr.Penale, në lidhje me gjykimin e shkurtuar;⁴⁷
- nenin 377 të K.Pr.Penale, lidhur me të drejtën e prokurorit që gjatë gjykimit të çështjes të tërheq akuzën dhe nenin 152 të K.Pr.Penale në funksion të analizimit të fuqisë provuese të provave;⁴⁸
- interpreton në mënyrë sistematike nenet 142, pika 1 të Kushtetutës, nenet 112/3, 382 dhe 383 të K.Pr.Penale lidhur me detyrimin e gjykatës për arsyetimin e vendimit gjyqësor, si dhe elementët e domosdoshëm të një vendimi gjyqësor;
- interpreton dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me konceptin e flagrancës dhe vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim, (nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale) në lidhje me kushtet (e përgjithshme dhe të veçanta) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit;⁴⁹
- në vendimin penal me objekt ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal gjyqtarja interpreton nenet 328 dhe 329 të K.Pr.Penale, lidhur me kompetencat e prokurorit gjatë hetimit dhe marrjes së një vendimi përkatës, si dhe kontrollin

⁴⁵Vendimi nr.168, datë 30.04.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁶Vendimi nr.320, datë 27.11.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁷Vendimi nr.175, datë 03.05.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁸Vendimi nr.216, datë 23.11.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁹Vendimi nr.87, datë 02.05.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

gjyqësor të këtyre vendimeve, para dhe pas ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin 35/2017;⁵⁰

- *Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.*

Në vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- Nenin 278 të K.Penal, i cili sanksionon mbajtjen pa leje të armëve luftarake, duke e ndaluar në mënyrë të veçantë të ndryshimet që ka pësuar ky nen. Në këtë kontekst, gjyqtarja referon në vendimin nr.9, datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, vendim i cili ka shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të K.Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014;⁵¹
- Aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar ku evidentohet se gjyqtarja referon dhe zbaton vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁵²
- Parimin e “*gjësë së gjykuar*”, duke referuar në Vendimin nr.24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese, në funksion të argumentimit se “*gjëja e gjykuar*” përfshin jo vetëm objektin dhe urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe tu përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj;⁵³
- Detyrimin e gjykatës për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen. Në këtë kontekst, gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues nr.3, datë 29.03.2012, lidhur me përcaktimin e shkakut të padisë.
- Gjyqtarja për të dhënë kuptimit e veprimit juridik të pavlefshëm referon në Vendimin Unifikues nr.5, datë 30.12.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁵⁴
- Gjyqtarja referon në disa vendimmarrje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*vendimet nr.140, datë 16.09.2015, nr.38, datë 25.01.2001, nr.77, datë 31.05.2017, nr.152, datë 30.09.2015, nr.146, datë 23.09.2015 etj.*), për të bërë dallimin midis gjendjes së ndikimit dhe tronditjes psikike, si rrethanë lehtësuese që ndikon në uljen e dënimit, sipas nenit 48, paragrafi 1 shkronja b të K.Penal dhe gjendjes së tronditjes psikike, të parashikuar nga neni 82 dhe 88/a të K.Penal;⁵⁵
- Edhe pse nuk konstatohet që gjyqtarja t’i jetë referuar në mënyrë eksplicite vendimit unifikues të vitit 2007 në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mënyra e arsyetimit, interpretimit dhe zgjidhjes së çështjes tregon se janë respektuar konkluzionet e arritura në këtë vendim unifikues dhe analiza e koncepteve ligjore janë deduksion dhe rrjedhojë e respektimit të këtij vendimi;⁵⁶
- Gjykata referon edhe në praktikën gjyqësore të mbajtur nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, duke specifikuar dhe referuar në vendimet nr.33, datë

⁵⁰Vendimi nr.320, datë 27.11.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵¹Vendimi nr.728, datë 23.07.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵²Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵³Vendimi nr.446, datë 27.06.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁴Vendimi nr.78, datë 13.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁵Vendimet nr.175, datë 03.05.2019 dhe nr.940, datë 06.12.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁶Vendimi nr.312, datë 11.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër

08.12.2015 dhe nr.14, datë 03.05.2011, me qëllim për të analizuar detyrimin e gjykatës për arsyetimin e vendimit;⁵⁷

- Gjyqtarja referon në vendimin nr.21, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese duke evidentuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt;⁵⁸
- Gjykata referon në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë (*pa specifikuar vendim*) duke pasqyruar një paragraf të kësaj praktike, në të cilin është argumentuar: “Kultivimi i bimës narkotike parashikuar nga neni 284 i K.Penal kurrësi nuk lejon mundësinë që mbajtja e një bime tashmë të korrur të konsiderohet si fazë e kultivimit të saj”,⁵⁹
- Në funksion të cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të një prej të të pandehurve dhe dhënien e konceptit të bashkëpunimit gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues nr.4, datë 15.04.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁶⁰

-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur. Në mënyrë më specifike:

- Në vendimin nr. 728, datë 23.07.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjatë arsyetimit dhe analizës juridike, gjyqtarja aplikon *parimin e zbatimit të ligjit të kohës* dhe në këtë kontekst duke bërë dallimin midis dispozitës që ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes me dispozitën që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së faktit penal, referon dhe zbaton *parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm*.
- Gjatë arsyetimit dhe analizës juridike në vendimin nr.72, datë 02.02.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër, gjyqtarja referon te *parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit*, në funksion të argumentit se çështja shqyrtohet mbi bazë ankimi vetëm nga i pandehuri (*dhe duke qenë se nuk ka ankim nga organi i prokurorisë*), gjykata nuk mund ta rëndojë pozitën e tij.
- Evidentohet që në të gjitha vendimet penale të analizuara gjyqtarja aplikon *parimin e individualizimit të dënimit*.
- Ndërkohë në çështjet civile, konkretisht në vendimin nr.446, datë 27.06.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjyqtarja interpreton nenin 451/a të K.Pr.Civile, lidhur me vendimin e gjykatës që përbën gjë të gjykuar dhe fuqinë juridike të tij dhe në këtë kontekst analizon dhe zbaton parimin e “*gjësë së gjykuar*” dhe “*sigurisë juridike*”.
- Në vendimin nr.197, datë 28.03.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, gjyqtarja në funksion të përfundimit të saj për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin për rigjykim, referon në *parimin e paanshmërisë*, duke vlerësuar se ky parim është shkelur për shkak se i njëjti gjyqtar që ka shfaqur mendim mbi konfliktin objekt gjykimi, nuk ka dhënë dorëheqjen por ka vazhduar gjykimin duke shpallur dy vendime gjyqësore në lidhje me njëri tjetrin. Po ashtu, në vendimin

⁵⁷Vendimi nr.540, datë 25.05. 2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁸Vendimi nr.197, datë 28.03.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁹Vendimi nr.168, datë 30.04.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶⁰Vendimi nr.168, datë 30.04.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër

nr.320, datë 27.11.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjyqtarja referon në parimin e ligjshmërisë, duke evidentuar se edhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, kanë theksuar se gjykata vlerëson nëse prokurori ka zbatuar *parimin e ligjshmërisë*, nëse ka mbledhur prova për të vërtetuar akuzën dhe a është mbështetur mbi këto prova për të arritur në përfundimin nëse ekzistojnë kushtet për pushimin, mosfillimin apo dërgimin e çështjes penale në gjyq.

- Gjithashtu gjyqtarja duke iu referuar nenit 459 dhe 465 të K.Pr.Civile sipas së cilës gjykata e apelit e shqyrton çështjen mbi bazë ankimi dhe vetëm përse është parashtruar në ankim, tregon kujdes të mos cenojë disponime të shkallës së parë, për të cilat nuk është bërë ankim, pavarësisht të një përjasje ndryshe në lidhje me një fakt apo rrethanë të caktuar që do të mund të çonte në një konkluzion tjetër të arritur nga vendimi i shkallës së parë. Gjithashtu, konstatohet zbatimi i *parimit të procesit të rregullt ligjor, parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor dhe parimi i disponibilitetit të palëve* etj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mbështetje të analizës juridike të çështjes, gjyqtarja referon edhe në qëndrime të praktikës gjyqësore lidhur me koncepte të caktuara juridike, duke i dhënë vlerë të shtuar dhe duke qartësuar kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Këtij të fundit në të gjitha vendimet e analizuara i bëhet një zbërthim abstrakt i çdo elementi, bazuar në qëllimin e normës juridike, mbi të cilin gjyqtarja bazohet për t' i dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine,⁶¹ por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyese apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe në disa raste edhe duke e numërtuar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit pa përsëritje, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie ose konkluzionin mbi të cilin shtjellohen argumentet mbështetëse. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

⁶¹ Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize konstatohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme, dhe të mirëorganizuar, sa i përket prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit, ku në mënyrë të veçantë i kushton rëndësi pjesës përshkruese-arsyetuese në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Vendimet gjyqësor përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në Apel për të vijuar më pas me një konkluzion të gjykatës lidhur me bazueshmërinë e ankimit duke dhënë argumentet përkatëse, të cilat përgjithësisht strukturohen me pika. Në këtë kontekst, në vlerësimi e saj gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të disponimit mbi shkaqet e ankimit dhe konkluzionin lidhur me to.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Po kështu vendimet janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit duke ndjekur rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Gjyqtarja përdor një metodologji të unifikuar në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁶²

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, referuar shkaqeve të ankimit, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale (si vlerën provuese të provave në funksion të provueshmërisë së faktit penal, juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative,⁶³ kompetencën tokësore referuar rregulimeve të bëra në nenin 395 të K.Pr.Civile,⁶⁴ shkeljet procedurale që kanë të bëjnë me veçimin ne çështjes dhe mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar,⁶⁵ të drejtën e

⁶²Vendimi i GJEDNJ, çështja “Hadjanastassiou kundër Greqisë”.

⁶³Vendimi nr.421, datë 18.06.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁴Vendimi nr.79, datë 01.06.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁵Vendimi nr.175, datë 03.05.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

prokurorit që gjatë gjykimit të çështjes të tërheq akuzën,⁶⁶ kushteve dhe kriterëve procedurale për shqyrtimin e një ankimi ndaj një vendimi të gjykatave të shkallës së parë,⁶⁷ vlerësimin lidhur me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për pavlefshmërinë e akteve⁶⁸ apo kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit).

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Rezulton kujdesi i gjyqtarës në mënyrën e paraqitjes dhe analizës tërësore të fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete, posaçërisht në çështjet me natyrë komplekse ku përgjithësisht dominon komponenti analitik.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes, analiza e faktit dhe ajo ligjore, zhvillohen në mënyrë logjike, duke paraqitur argumente për secilin shkak ankimi. Norma ligjore zërthehet sipas qëllimit, duke i dhënë përgjigje shkakut konkret të ngritur në ankim, pa zgjatje dhe konfuzion, në rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur.

Argumentet ndjekin një linjë arsyetimi e cila zhvillohet në mënyrë dinamike mbi çdo fakt apo çështje të marrë në analizë, duke mbështetur në mënyrë logjike konkluzionin e arritur. Gjyqtarja tregon kujdes për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, nëpërmjet një analizë dhe interpretimi individual lidhur me kuptimin e tyre, duke i mbështetur më pas ato edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore kur është vlerësuar e nevojshme. Në mënyrë konkrete, në disa nga vendimet burim vlerësimi, ka rezultuar se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi të posaçme analizës abstrakte të instituteve, parimeve apo normave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet konkrete, konkretisht:

- (i) analizon konceptin e akteve për dhënien e kredive bankare, përkufizimin e konceptit të ristrukturimit të kredisë si dhe konceptit të veprimit juridik. Gjyqtarja analizon në mënyrë të përgjithshme kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik, pasojave juridike në rastin e cenimit të kushteve si dhe llojet e pavlefshmërisë së veprimit juridik;⁶⁹
- (ii) në disa vendime analizon padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, duke argumentuar se në këto lloj gjykimesh, gjykata përqendrohet në përcaktimin e titullit ekzekutiv, faktin nëse është i vlefshëm dhe i lëshuar në bazë të rregullave të titullit ekzekutiv si dhe analizon detyrimin konkret në ngarkim të debitorit, pra faktin nëse ky detyrim ekziston, në çfarë mase apo nëse është shuar më pas;⁷⁰
- (iii) analizon konceptin e kompetencës tokësore, referuar rregullimeve të bëra në nenin 395 të K.Pr.Civile duke vlerësuar se në këtë dispozitë është parashikuar

⁶⁶Vendimi nr.216, datë 23.11.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁷Vendimi nr.354, datë 19.12.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁸ Vendimi nr.65, datë 02.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁹Vendimi nr.78, datë 13.02.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁰Vendimet nr.78, datë 13.02.2017, nr.336, datë 16.05.2019, nr.208, datë 26.03.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

- se kompetencën në lëndë e kanë Gjykatat e Apelit pa përcaktuar rrethana të posaçme në lidhje me kompetencën tokësore;⁷¹
- (iv) Analizon konceptin e *ankimit* si një akt procedural, i cili kërkon respektimin rigoroz të disa kushteve që kanë të bëjnë me rastet, formën, mënyrën dhe afatin e paraqitjes së tij;⁷²
- (v) analizon konceptet ligjore, lidhur me faktin nëse kontrata e punës së paditësit ka qenë me afat apo jo, nëse është respektuar procedura dhe afati në zgjidhjen e kontratës, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes;⁷³
- (vi) analizon të drejtën për dëmshpërblim të drejtuesit të mjetit që pa fajin e tij ka pësuar një dëm pasuror apo jopasuror të caktuar, duke interpretuar nenin 11 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenin 2 të Rregullores nr.53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”;⁷⁴
- (vii) analizon të drejtën e pjesëmarrësve në një procedurë ekzekutimi (*kreditor, debitor*) për të kundërshtuar çdo veprim të përmbaruesit gjyqësor, afatin e ankimit si dhe karakteristikat individuale të procesit përmbarimor;⁷⁵
- (viii) në funksion të analizimit të parimit të paanshmërisë gjyqtarja jep konceptet e elementit subjektiv dhe objektiv, konceptin e paragjyqimit eventual për paanësinë e gjyqtarit;⁷⁶
- (ix) analizon në mënyrë të detajuar konceptin e *arsyetimit të vendimit* duke e cilësuar si një pjesë thelbësore të procesit të rregullt ligjor, i cili i njeh palët me qëndrimin e gjykatës lidhur me argumentet ligjorë, mënyrën si janë vlerësuar provat, rrethanat e faktit dhe arsyet pse gjykata ka marrë një vendim;⁷⁷
- (x) analizon parimin e zbatimit të ligjit në kohë, zbatimin e ligjit favorizues, “*gjënë e gjykuar*”, “*sigurinë juridike*”, “*parimin e ligjshmërisë dhe paanësisë*”, duke bërë një analizë të detajuar të tyre.
- (xi) Në vendimet penale konstatohet analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale, si dhe autorësinë. Gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë analizës së integruar të provave në raport me katër elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, duke konkluduar më pas për bazueshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kryerjen dhe kualifikimin e faktit penal. Gjithashtu, gjyqtarja i kushton rëndësi individualizimit të dënimit, duke marrë në analizë rrethanat konkrete të çështjes në raport me parashikimet e nenit 47 e vijues të K. Penal që disiplinon caktimin e dënimit. Në vendimin nr.168, datë vendimi 30.04.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjyqtarja në funksion të cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të një prej të pandehurve jep konceptit e *bashkëpunimit* referuar në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.4, datë 15.04.2011. Në vendimin nr.940, datë vendimi 06.12.2018 të Gjykatës së

⁷¹Vendimi nr.79, datë 01.06.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷²Vendimi nr.354, datë 19.12.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷³Vendimi nr.312, datë 11.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁴Vendimi nr.359, datë 25.05.2017 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁵Vendimi nr.488, datë 17.07.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁶Vendimi nr.197, datë 28.03.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁷Vendimi nr.540, datë 25.05.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Apelit Shkodër gjyqtarja analizon konceptin e tronditjes psikike dhe nevojës ekstreme, për të konkluduar në cilësimin e drejtë juridik të bërë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit në rastin konkret si subjekt i posaçëm;

- (xii) analizon konceptin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, në funksion të aplikimit në mënyrë proporcionale të kufizimit të të drejtave dhe lirisë së personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, së bashku me analizën e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit personal;⁷⁸
- (xiii) analizon në mënyrë të detajuar kompetencat e prokurorit gjatë hetimit dhe marrjes së një vendimi përkatës (*si mosfillimi i çështjes, pushimi i hetimeve apo dërgimi i çështjes në gjyq*). Në këtë kontekst gjyqtarja analizon se para ndryshimeve të K.Pr.Penale, me ligjin nr.35/2017 hetimi dhe marrja e një vendimi përkatës ka qenë kompetencë ekskluzive e prokurorit në çfarëdo veprë penale. Këto vendime mbi bazën e ankimit të palëve të interesuara mund të bëheshin objekt kontrolli gjyqësor dhe ishte gjykata që vlerësonte ligjshmërinë e këtyre vendimeve. Më tej gjyqtarja analizon ndryshimet rrënjësore të realizuar me ligjin nr.35/2017 lidhur me kompetencën e prokurorit në hetime paraprake dhe të drejtën e gjykatës për të kontrolluar vendimmarrjen e prokurorit, duke evidentuar dhe risinë apo konceptin e *gjyqtarit të seancës paraprake*.⁷⁹

Në tërësi arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga palët, si dhe çështjeve me karakter procedural të vlerësuara të nevojshme për tu analizuar nga ana e gjykatës.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se shkaqet e ankimit merren në analizë nga ana e gjyqtarës dhe iu jepet në çdo rast përgjigje e argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjes, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së saj, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit të marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t’i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor.

⁷⁸Vendimi nr.87, datë 02.05.2018 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁷⁹Vendimi nr.320, datë 27.11.2019 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë 275 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, nga të cilat 53 çështje ose 19.27% e tyre kanë përfunduar tej këtij afati.

Pavarësisht këtij raporti të pasqyruar në Raportin Analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Apelit Shkodër,⁸⁰ për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 238 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (46 çështje në vitin 2017, 81 çështje në vitin 2018 dhe 111 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë parapake” dhe “Çështje gjyqësore të juridiksionit fillestar”.

Afati ligjor 60 ditë për përfundimin e çështjeve me objekt “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv”, është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016, ligj ky i cili është miratuar në datë 03.11.2016

⁸⁰Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit 2017-2019 janë dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër nëpërmjet postës elektronike në datën 21.09.2021.

dhe ka hyrë në fuqi në datë 30.11.2016, pra 15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare nr. 219 datë 15.11.2016. Në tabelën nr.1, viti 2017 evidentohet se 12 (dymbëdhjetë)⁸¹ çështje janë regjistruar në Gjykatën e Apelit përpara këtyre ndryshimeve dhe si rrjedhojë vlerësohet se afati 60 ditë për përfundimin e këtyre çështjeve nuk duhet të llogaritet si afat për gjykimin e çështjes në Apel, por duhet të konsiderohen si çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim nuk ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të çështjes/ankimit në Gjykatën e Apelit.

Gjithashtu, edhe afati ligjor për përfundimin e çështjeve me objekt “*Kundërshtim i veprimeve përmbartimore*” (30 ditë kur çështja shqyrtohet në dhomë këshillimi dhe 45 ditë kur çështja shqyrtohet në seancë) është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë K.Pr.Civile me ligjin nr.114/2016. Në tabelën nr.1, viti 2017 dhe viti 2018 evidentohet 2 (dy)⁸² çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit në datën 22.09.2015 dhe 15.10.2016, pra përpara ndryshimeve të bëra me ligjin 114/2016, dhe si rrjedhojë këto çështje do të konsiderohen si çështje me afat standard minimal kohor.

Afati 30 ditor për përfundimin e çështjes me objekt “*Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit*” dhe afati 15 ditor për përfundimin e çështjes me objekt “*Kundërshtim vendim pushimi procedimi*” të parashikuar respektivisht në nenet 291 pika 5 dhe 329 pika 7 të K.Pr.Penale, janë parashikuar për herë të parë me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.08.2017. Në tabelën nr.11, të vitit 2017 evidentohen se nga 26 (njëzet e gjashtë) çështje vetëm 5 (pesë) prej tyre janë regjistruar në gjykatë, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, ndërsa 21 (njëzet e një) çështjet e tjera janë regjistruar në gjykatë përpara gushtit të vitit 2017, dhe si pasojë do të konsiderohen çështje me afat standard minimal kohor.

Në tabelën nr. 3 të të dhënave statistikore, viti 2018, për çështjet e kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, rezulton se çështja me objekt “*Urdhër mbrojtje*”,⁸³ është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 24.01.2018, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar,⁸⁴ ku në nenin 21/2 të tij përcaktohet afati ligjor prej 15 ditësh për përfundimin e gjykimit nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit). Duke qenë se kjo çështje është regjistruar para hyrjes në fuqi të ligjit 47/2018, kjo çështje do të kategorizohet si çështje me afat standard.⁸⁵

⁸¹Çështjet me numër rendor 1-5, 7, 8, 10, 11, 16, 18 dhe 24, Tabela nr.1, viti 2017

⁸²Çështja me numër rendor 20, Tabela nr.1, viti 2017; Çështja me numër rendor 38, Tabela nr.1, viti 2018

⁸³Çështja me numër rendor 2

⁸⁴Ligji është miratuar në datën 23.07.2018 dhe ka hyrë në fuqi në datën 18.08.2018 (Fletore zyrtare nr.118/2018, datë 03.08.2018)

⁸⁵ Në nenin 21 pika 2 të ligjit në fuqi në kohën e regjistrimit të çështjes parashikonte: “Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankim brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.”

Në tabelën nr.14, viti 2018 dhe 2019, tek kategoria “Çështje gjyqësore në juridiksionin fillestar” lidhur me kërkesat me objekt “Përfundim gjyqtari”, rezulton se nga 19 (nëntëmbëdhjetë) kërkesa të përfunduara, vetëm 10 (dhjetë)⁸⁶ prej tyre janë kërkesa të paraqitura gjatë një procesi penal, për të cilat nenin 22/3 i K.Pr.Penale parashikon afat ligjor shqyrtimi prej 48 orësh nga paraqitja e kërkesë. Rezulton të jenë shqyrtuar tej këtij afati ligjor 2 (dy) kërkesa, përkatësisht me një tejkalim prej 19 ditë dhe 5 ditë.⁸⁷

Sa më sipër, pas një rianalize të të dhënave statistikore bazuar në dispozitat që parashikojnë afat ligjor të zbatueshëm për çdo çështje, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (42 çështje),⁸⁸ me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (238 çështje), rezulton që të jetë 17.64% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në formularin e vetëvlerësimit në lidhje me këtë kriter vlerësimi gjyqtarja ka sqaruar se në periudhën e vlerësimit është përballur me një numër të lartë të dosjeve të ardhura për gjykim, për shkak të pezullimit nga organet e rivlerësimit të disa gjyqtarëve (një gjyqtar në vitin 2018 dhe dy gjyqtarë në vitin 2019), dosje të cilat janë rishortuar mes gjyqtarëve të mbetur. Gjithashtu, gjyqtarja ka argumentuar se është përballur me një numër të lartë çështjesh që kanë afate të ngutshme ligjore gjykimi, me një numër të lartë të kërkesave për përshpejtimin e çështjeve (kryesisht çështje civile me objekt “Përfitim e drejtë pensioni”, “Zgjidhje martesë”, “Zgjidhje e marrëdhënie pune”), duke u krijuar një ngarkesë të paparashikueshme. Duke iu referuar vitit 2017 gjyqtarja ka argumentuar se për këtë vit duhet të merren në konsideratë fakti që ka qenë në gjendje shëndetësore jo e mirë për shkak të shtatzënisë, si dhe faktin që ka qenë me leje barrëlindje për një periudhë gati 4 mujore.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 42 (dyzet e dy) çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, evidentohet se në disa raste këto vonesa në shqyrtim kanë qenë të papërfillshme. Konkretisht:

⁸⁶Çështjet me numër rendor 7, 12, 13, 14, 15, 16 (viti 2018) dhe çështjet me numër rendor 1, 19 dhe 27 (viti 2019), janë kërkesa të paraqitur gjatë një procesi civil, për të cilat nenin 74 dhe 75 i K.Pr.Civile nuk parashikon afat shqyrtimi.

⁸⁷Çështja me numër rendor 10 dhe 11 në Tabelën nr.14, viti 2019.

⁸⁸Viti 2017 - Tabela nr.2, çështja me numër rendor 3; Tabela nr.10, çështjet me numër rendor 2, 3, 7, 20, 21, 38, 39; Tabela nr.11, çështja me numër rendor 26;

Viti 2018 - Tabela nr.1, çështjet me numër rendor 66; Tabela nr.2, çështjet me numër rendor 3,7; Tabela nr.10, çështjet me numër rendor 13, 26, 31, 32, 34, 44; Tabela nr.11, çështjet me numër rendor 4, 6, 12, 20;

Viti 2019 - Tabela nr.2, çështja me numër rendor 17; Tabela nr.2, çështja me numër rendor 30 (çështja është pasqyruar gabimisht tek tabela nr.2, pasi është çështje familjare me palë kundërshtare); Tabela nr.10, çështjet me numër rendor 11, 12, 13, 14, 17, 20, 23, 37; Tabela nr.11, çështjet me numër rendor 2, 8, 10, 21, 24, 25, 27, 31; Tabela nr.14, çështjet me numër rendor 10, 11.

- 1 (një) çështje⁸⁹ me objekt “*Lëshim urdhër ekzekutimi*”, ka përfunduar jashtë afatit ligjor 5 ditor të përcaktuar në nenin 510 të K.Pr.Civile,⁹⁰ e cila ka përfunduar për 9 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor vetëm me 4 ditë. Tejkalim ky i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë çështja konsiderohet e shqyrtuar në afat ligjor.
- 1 (një) çështje⁹¹ me objekt “*Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv*”, ka përfunduar jashtë afatit ligjor (60 ditë) të parashikuar në nenin 609 të K.Pr.Civile. Kjo çështje ka përfunduar për 66 ditë, duke tejkaluar me vetëm 6 ditë afatin ligjor të gjykimit, tejkalim i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë çështja konsiderohet e shqyrtuara në afat ligjor.
- për 1 (një) çështje⁹² me objekt “*Sigurim padie*”, vendimi është marrë për një afat prej 6 ditësh, duke tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- 1 (një) çështje, me objekt “*Lëshim urdhër mbrojtje*”, ka përfunduar jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga neni 21, pika 2⁹³ i ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështja me numër rendor 30, viti 2019 kanë përfunduar për 18 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin ligjor të gjykimit, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit.
- 10 (dhjetë) çështje nga kategoria “Penale seancë paraprake”, me objekt “*Ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes*”, të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga neni 239, pika 7⁹⁴ i K.Pr.Penale. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se 3 (tre) çështje kanë përfunduar përkatësisht për 17, 19 dhe 20 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me 2 deri në 5 ditë, çka nuk zë peshë për volumin e madh të çështjeve të gjykuara nga gjyqtarja si relator. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 7 çështje.

Sa më sipër, në total nga 238 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e sipërcituara), rezulton që gjyqtarja ka përfunduar jashtë afatit ligjor 35 çështje ose rreth 14.7% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, e cila pikëzohet me 12 pikë.

⁸⁹Çështjet me numër rendor 3 në tabelën nr.2 viti 2017. Kërkesa është regjistruara para datës 07.11.2017, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë

⁹⁰Kërkesa është regjistruara para datës 07.11.2017, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

⁹¹Çështjet me numër rendor 66 në tabelën nr.1 viti 2018.

⁹²Çështjet me numër rendor 7 në tabelën nr.2 viti 2018.

⁹³Në nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 9669/2006, parashikohet se “2. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim. Ankimi paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni. Gjykata e apelit vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë”.

⁹⁴ Në nenin 329, pika 7 të K.Pr.P parashikohet se “7. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve.”.

Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit, në total ka gjykuar 836 çështje si relatores dhe 1612 çështje si anëtare.

KONKLuzioni

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Për pikëzimin në rastin konkret duke pasur në konsideratë:

- i) ngarkesën e lartë të gjyqtarës si relatores dhe anëtare;
- ii) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) gjendjen shëndetësore, si dhe faktin që gjyqtarja ka qenë me leje barrë lindje 4 mujore gjatë vitit 2017;
- iv) numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor ku gjyqtarja ka qenë relatores, 238 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 28% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit;
- v) tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal të këtij treguesi me vetëm 4,7 %.

vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se sa rezulton nga të dhënat statistikore, dhe konkretisht me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, duke u rritur me një nivel në pikëzim, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 14,7 %, por ndërkohë gjyqtarja ka përfunduar një numër tepër të lartë çështjesh ku 28% se 238 janë çështje me afat ligjor.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, duke iu referuar standardit minimal kohor të përcaktuar në vendimin nr.261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së,⁹⁵ rezulton se nga **598**

⁹⁵Në pikën 5 shkronja “g”, “h” dhe “k” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve nga gjykatat e apelit, parashikohet se: “g. Gjykimet penale në gjykatën e apelit, jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. h. Gjykimet civile në gjykatën e

çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, **18**⁹⁶ prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë **3%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.⁹⁷

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në 97% të çështjeve, duke u tejkaluar ky standard vetëm në 3% të çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë dhe vlerësohet për nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi, sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, *më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*. Konkretisht:

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 45.27 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej gjashtë muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 26.52 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 27.55 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 36.8 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;

apelit, jo më tej se 6 muaj. k. Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e apelit, jo më tej respektivisht se 2 dhe 4 muaj”.

⁹⁶Viti 2018 - Tabela nr.1, çështjet me numër rendor 59, 79, 84; Tabela nr.8, çështjet me numër rendor 53,86; Tabela nr.12, çështjet me numër rendor 3, 6, 8, 10;

Viti 2019 - Tabela nr.1, çështja me numër rendor 49,64; Tabela nr.8, çështja me numër rendor 2; Tabela nr.11, çështjet me numër rendor 9 (*çështja është pasqyruar gabimisht tek tabela nr.11, pasi është kërkesë në fazën e ekzekutimit*); Tabela nr.12, çështjet me numër rendor 6, 7, 8, 9, 10.

⁹⁷Në vendimin nr. 60, datë 30.01.2020 të KLGJ “Për miratimin e udhëzuesit për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” përcaktohet se për çështjet për të cilat nuk ka afat ligjor gjykimi, afati i përfundimit të gjykimit është periudha kohore nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim nga gjyqtari relator subjekt vlerësimi deri në datën e shpalljes së vendimi.

- v. Në kategorinë e çështjeve “Penale-krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 58.60 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 apo 9 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake-Kundërshtim vendim pushimi të procedimit penal” apo “Kundërshtim vendim mosfillimi procedimi”,⁹⁸ koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 28.76 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”,⁹⁹ koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 57.53 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.
- viii. Në kategorinë e çështjeve “Juridiksion fillestar”,¹⁰⁰ koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 19.79 ditë, pra *më e shkurtër* se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pavarësisht volumit të çështjeve, specifikave të gjykimit në apel në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra, duke treguar shkallë të lartë aftësie.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (836 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (785 çështje), është 106.49%.

⁹⁸ Në përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për këtë kategori janë përfshirë çështjet e regjistruar në gjykatë para ndryshimeve ligjore të bëra në K.Pr.Penale me ligjin nr.35/2017.

⁹⁹Në përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për këtë kategori përveç çështjeve të pasqyruar në Tabelën nr.12, viti 2017, 2018 dhe 2019, janë përfshirë edhe 2 (dy) çështjet e pasqyruara gabimisht në Tabelën nr.14, viti 2018, numër rendor 14, me objekt “Rishikim vendimi penal”, si dhe në Tabelën nr.11, viti 2019 çështja me numër rendor 9, me objekt “Rishikim vendimi penal te formës së prerë”

¹⁰⁰Në përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për këtë kategori nuk janë përfshirë çështjet me objekt “Përrjashtim gjyqtari”, të cilat janë paraqitur në kuadër të një procesi penal, pasi për këto kërkesa ligji procedural penale parashikon afate ligjore shqyrtimi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 106.49%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” i cili është “+99%”, gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 10.8 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- (ii) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 9.05 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- (iii) Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 15.8 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- (iv) Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 11.8 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- (v) Për çështje të kategorisë “Penale krime”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 7.25 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar në nenin 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (vi) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, me objekte referuar neneve 228, 248, 249/6, 260 dhe 261 të K.Pr.Penale, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 4.7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë;
- (vii) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 9.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar në nenin 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (viii) Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake”, për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit është 8.9 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar në nenin 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (ix) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 8.25 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar në nenin 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;

- (x) Për çështje të kategorisë “Juridiksion fillestar”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 7.04 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 20 apo 30 ditë i parashikuar në neni 308 të K.Pr.Civile apo neni 430/1 pg. 4 i K.Pr.Penale.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër se afati procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, prandaj gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, referuar 17 (shtatëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar është **2.6 seanca gjyqësore** (duke përjashtuar çështjet pa palë kundërshtare). Në lidhje me numrin e seancave gjyqësore **për çdo kategori çështjesh**, rezultojnë të dhënat si më poshtë vijon:

- (i) Për çështje të kategorisë “Civile me palë kundërshtare” numri mesatar i seancave është 1.2 seanca;
- (ii) Për çështje të kategorisë “Penale krime” numri mesatar i seancave është 4.3 seanca;
- (iii) Për çështje të kategorisë “Seance paraprake” numri mesatar i seancave është 1 seancë.

Po kështu, nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Rezulton që seancat janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës, dhe po kështu seancat gjyqësore janë shtyrë brenda afateve të arsyeshme në raport me shkakun e shtyrjes.

Disa nga shkaqet kryesore për të cilën janë shtyrë seancat gjyqësore janë: (i) për t'i garantuar palës paditëse të drejtën e mbrojtjes apo për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur për tu njohur me dosjen,¹⁰¹ (ii) për të marrë informacion zyrtar lidhur me faktin e konstatuar në seancë se kërkuesi ka ndërruar jetë,¹⁰² (iii) me qëllim njoftimin rregullisht të të pandehurve, (iv) për njoftimin e dëshmitarëve, apo (v) për paraqitjen me shkrim të konkluzioneve përfundimtare.¹⁰³ Gjithashtu rezulton se disa seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues.¹⁰⁴

Konkretisht, në çështjen e përzgjedhur me short me nr.54/442/929, regjistri, datë regjistrimi 29.04.2016, me nr. 540 vendimi, datë 25.05.2018 rezulton se seancat gjyqësore të datave 23.11.2017, 07.12.2017, 20.12.2017, 11.01.2018, 25.01.2018, 08.02.2018, 22.02.2018, 12.03.2018, 26.03.2018, 11.04.2018, 26.04.2018 dhe e datës 09.05.2018, janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, në kushtet kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka deleguar gjyqtarin e tretë në përbërje të trupit gjykues apo për shkak të mosparaqitjes së dy anëtarëve të trupit gjykues për shkak të gjykimeve të tjera (*seanca e datës 09.05.2018*). Në seancën e datës 12.03.2018 rezulton se gjyqtarja me qëllim shmangien e seancave produktive ka vlerësuar se duhej përsëritur edhe njëherë shkresa drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke cituar në të zvarritjen e gjykimit për shkak të mosformimit të trupit gjykues.

Nga 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje të përzgjedhura me short rezulton se 12 (dymbëdhjetë) prej tyre kanë përfunduar me 1 (një) seancë, çka tregon kujdesin e gjyqtarës për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Sa më sipër, në tërësi konstatohet se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës relatores, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e

¹⁰¹ Shih çështjen me nr.984 Regj., datë 22.02.2019 me nr. 336 vendimi, datë 16.05.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, me objekt pavlefshmëri të faturave të energjisë elektrike.

¹⁰² Shih çështjen me nr.329 Regj. Them., me nr. 354 vendimi, datë 19.12.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, me objekt aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ.

¹⁰³ Shih çështjen me nr.80/702/1377 Regj. Them., me nr. 168 vendimi, datë 30.04.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

¹⁰⁴ Në çështjet me nr.54/442/929, Regj., Them., datë 29.04.2016, me nr. 540 vendimi, datë 25.05.2018, si dhe në çështjen me nr.80/702/1377 Regj., Them., datë 13.03.2017 datë, me nr.168 vendimi, datë 30.04.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

çështjeve të mos bëhej shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtarë është 2.6 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.6 seanca dhe gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se, në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.¹⁰⁵

Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas nenit 461 të K.Pr.Civile, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

¹⁰⁵ Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale

Përgjithësisht seancat kanë filluar në kohë, me vonesa të vogla. Në ato seanca në të cilat procesi ka filluar me vonesë, nga ana e gjyqtarës është relatuar gjithmonë shkaku, vonesa këto të shkaktuara për shkaqe të pavarura nga ana e relatorit.

Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...} () ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civile e penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori.

Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik pas çdo seancë gjyqësore, provat e administruara për herë të parë në dosje (në rastin e përsëritjes të hetimit gjyqësor), diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (provat e paraqitura për herë të parë në Gjykimin në Apel, diskutimet përfundimtare të palëve), aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit, apo prania e akteve e dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2017-2019, ndaj gjyqtarës rezulton të jenë paraqitur 4 (katër) ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 2708/1 prot, datë 12.07.2021, nr. 714/2 prot., datë 21.01.2022, nr. 970/2 prot., datë 28.06.2022 dhe nr. 789/7 prot, datë 05.01.2023 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesa e shtetasit {...}., depozituar në KLGJ me nr. 308 prot, datë 21.01.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.790 prot, datë 01.06.2020, nëpërmjet të cilës ankuesi parashtron pafajësinë e tij lidhur me procedimin penal të regjistruar në ngarkim të tij, por nuk ngre ndonjë pretendim lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, vlerësimit të provave apo ndonjë pretendim për zbatim të gabuar apo mosrespektim të ligji procedural penal apo material. ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr.2708/1 prot, datë 12.07.2021 duke arsyetuar se ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë, referuar nenit 120, pika 1, shkronjat “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

II- Ankesa e shtetasi {...}, depozituar në ish-KLD në datën 26.10.2018, është përcjellë pranë Zyrës së ILD duke u regjistruar me nr. 714 prot, datë 09.02.2021, konsiston në pretendimet për vendimmarrje të pambështetur në prova dhe në ligj, në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr.290, datë 25.04.2018. ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 714/2 prot, datë 21.01.2022 duke arsyetuar se: *“Rrethanat e paraqitura nga ankuesi, vlerësohet se janë pretendime në terma të përgjithshëm të pashoqëruara me argumente dhe prova konkrete, të gjitha pretendimet e ankuesi, të paraqitura në padinë e paraqitur në gjykatë, i janë nënshtruar shqyrtimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes së gjykatës respektive, për të cilën vlerësohet se janë pretendime për vlerësimin e padisë e provave në gjykim, të cilat janë kompetence e gjykatës që shqyrton çështjen e cila bën vlerësimin dhe çmuarjen e tyre sipas bindjes së brendshme, duke disponuar për mënyrën e zgjidhjes përfundimtare të procesit. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile trajnimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimi ndaj vendimit gjyqësor...Për rrjedhojë, vlerësohet se ankesa nuk përmbush kriterin për pranueshmëri, të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e*

Shqipërisë”, i ndryshuar. Për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2, shkronja “a” të këtij ligji”.

III- Ankesa e shtetasës {...}, depozituar në KLGJ me nr. 1073 prot, datë 18.02.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.944 prot, datë 08.06.2020, konsiston në pretendime për zvarritje të gjyqimit për rreth 5 muaj dhe për një vendimmarrje të padrejtë, në çështjen civile të përfunduar me vendimi nr.689, datë 29.10.2018. me vendimin nr.2843/1 Prot., datë 21.06.2021 ILD ka vendosur verifikimin e ankesës të paraqitur nga ankuesja {...} , ndaj veprimtarisë së magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër. Nga verifikimi i kryer lidhur me këtë ankesë, ILD me vendimin nr.970/2 Prot., datë 28.06.2022 ka vlerësuar se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor dhe në këto kushte ankesa duhet të arkivohet referuar nenit 122, pika 4 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dh prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

IV- Ankesa e shtetasit {...} , depozituar në ish-KLD, përcjell pranë Zyrës së ILD, regjistruar me nr.1176, datë 22.02.2021 konsiston në pretendimet për zvarritje të gjyqimit, vendimmarrje të padrejtë dhe mos dërgimin në kohë të dosjes gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë, lidhur me çështjen civile të përfunduar me vendimin nr.61, datë 29.01.2018. ILD, duke marr shkas nga pretendimet e ankuesit, për të verifikuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor ndaj trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkodër , me vendimin nr.789/1 prot., datë 01.06.2022 ka vlerësuar marrjen e të dhënave shtesë për verifikimin e ankesës. Pas verifikimit të ankesës, me vendimin nr.789/7 prot., datë 05.01.2013, ILD ka vendosur për arkivimin e ankesës me arsyetimin: *“Nga shqyrtimi i ankesës, pretendimeve të paraqitura dhe dokumentacioni i mbledhur në kudër të verifikimit të saj me vendimin nr.789/1 port., datë 01.06.2022, nuk ka fakte të mjaftueshme dhe nuk evidentohet të dhëna se sjellja apo veprimet e magjistratëve në dhënien e vendimit objekt ankese, janë të natyrë të tillë që të përben shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr.96/2016. Sa më sipër, ankesa e {...} ., regjistruar në ILD me nr.1176 prot., datë 22.02.2021, ndaj magjistratëve duhet të arkivohet bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtares subjekt vlerësimi.

Gjyqtarja dhe kryetari gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë

tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, etika e gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 4 (katër) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 2708/1 prot, datë 12.07.2021, nr. 714/2 prot., datë 21.01.2022, nr. 970/2 prot., datë 28.06.2022 dhe nr. 789/7 prot, datë 05.01.2023, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...} , gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se për gjyqtaren {...}: a) Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga Kryetari i Gjykatës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarës, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarës

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i Kryetarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi për gjyqtaren {...} (), për periudhën e vlerësimit, të përcjellë nga Gjykata e Apelit Shkodër për vitin 2017 janë paraqitur 3 (tre) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 1 (një) është pranuar dhe 2 (dy) janë rrëzuar, ndërsa ka pasur 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 8 (tetë) janë pranuar dhe 3 (tre) janë rrëzuar.

Në vitin 2018 janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 5 (pesë) janë pranuar dhe 2 (dy) janë rrëzuar, ndërkohë ka pasur 28 (njëzet e tetë) kërkesa për heqje dorë nga gjykimi, nga të cilat 12 (dymbëdhjetë) janë pranuar dhe janë 16 (gjashtëmbëdhjetë) janë rrëzuar.

Për vitin 2019 gjyqtarja ka pasur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 2 (dy) kërkesa janë pranuar dhe 5 (pesë) janë rrëzuar, ndërsa rezultojnë 12 (dymbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 7 (shtatë) janë pranuar dhe 5 (pesë) janë rrëzuar.

KONKLuzioni

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paañesi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares (vetëm 8 kërkesa për një periudhë 3 vjeçare), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit për shkak të konfliktit të interesit të vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente dhe e kuptueshme.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me administratën e gjykatës dhe ky bashkëpunim vihet re në mbarëvajtjen e punës dhe eliminimin e pengesave që dalin gjatë ushtrimit të funksionit. Gjyqtarja është treguar gjithmonë e gatshme për dhënien e ndihmës në trajnimin e personelit të punësuar rishtazi.

KONKLZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...} , gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertës, lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e ekspertës në Programin e Formimit Vazhdues në 3 (tre) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej në 4 (katër) ditë trajnim;
- (i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 2 (dy) ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 16 (gjashtëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 27.5 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës, 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë si moderator me 1.5 si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...} , gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 41.5 ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit.

Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë gjyqtarja, rezulton se në periudhën 24-26 prill 2018, gjyqtarja {...} ka qenë pjesëmarrëse në një aktivitet 3 (tre) ditor organizuar nga European Asylum Support Office, aktivitet ky jashtë programit të

formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, e cila rezulton të jetë aktivitet i formimit profesional.¹⁰⁶

KONKLZIONI

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 20 aktivitete trajnuese të shtrira në 41.5 ditë trajnimi, si dhe në 1 (një) aktivitet trajnues jashtë Shkollës së Magjistraturës të shtrirë në 3 ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës, rezulton se me shkresën nr. 357/1 prot., datë 28.07.2021 subjekti i vlerësimit {...} të ketë marrë pjesë me cilësinë e ekspertës dhe lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve në trajnimin me temë:

- i. “Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike; Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus nenet 133-142/a të Kodit të Procedurës Penale; Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; Njoftimi i të pandehurit person juridik; Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet”, trajnime të zhvilluar në datën 12 janar 2018 dhe 9 shkurt 2018 (në cilësinë e ekspertës);
- ii. “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile; Risitë e Kodit të Procedurës Civile; Urdhri i ekzekutimit; Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv; Kundërshtimi i veprimeve përmbardimore; Pezullimi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë; Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore shqiptare; Pasojat nga prishja e vendimit të dhënë me ekzekutim të përkohshëm me fokus nenin 319 të Kodit të Procedurës Civile; Kuptimi i nenit 317 të K.Pr.Civile dhe rastet në të cilat vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm; Momenti i parashtrimt të kërkesës për dhënie me ekzekutim të përkohshëm; Kuptimi i nenit 319 të K.Pr.Civile në lidhje me pasojat që vijnë nga prishja e vendimit të dhënë me ekzekutim të përkohshëm dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i tij nga shërbimi përmbardimor”, trajnime të zhvilluara në data 23-24 janar 2019 (në cilësinë e lehtësuese) dhe në data 6-7 mars 2019 (në cilësinë e ekspertës).

¹⁰⁶ Për trajnimin e sipërcituar, gjyqtarja me shkresën e datës 31.10.2022, protokolluar në KLGJ me nr. 5565/1 prot., datë 03.11.2022 ka paraqitur edhe ftesën e këtij trajnimi të dërguar nga European Asylum Support Office.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë, dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se për gjyqtaren {...} duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë eksperte dhe lehtësuese në trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...} me Vendimin nr.280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar gjyqtare për mediat në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Gjithashtu rezulton se me shkresën e datës 20.10.2022, protokolluar në KLGJ me nr.5565 prot., datë 24.10.2022, gjyqtarja në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional ka depozituar disa akte, ndër të cilat Manualin e Standardeve Gjyqësore Minimale në Procedimet Disiplinore të Gjyqtarëve, hartuar përgjatë një pune disa mujore nga grupi i punës European Network of Councils for the Judiciary (ENCJ), manual në të cilin gjyqtarja ka punuar pjesën që i përket Shqipërisë, por konstatohet që ky angazhim i gjyqtares është jashtë periudhës së vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019).

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë për shkak të angazhimit të saj si gjyqtare për mediat në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja {...} () të jetë angazhuar në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në juridiksionin e ish/Gjykatës së Apelit Shkodër.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter

Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} ()
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total		Niveli i vlerësimit
			100		Shkëlqyeshëm
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

		përzgjedhura për vlerësim			Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë

					Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e

		kryetarit			aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë

					Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			395		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR